

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /08/2025

LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

I mbajtur sot në datë 28.08.2025 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës, të emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 702/3 Prot, datë 28.08.2025 për procedurën e prokurimit me objekt: “Çelësa TL/TM, Ndarësa TL/TM dhe TT për ambjent të jashtëm”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Pajisje elektrike 31681000-3.

Vlera e fondit limit: 141,967,311.86 (Njëqind e dyzet e një milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëmbëdhjetë lekë dhe tetëdhjetë e gjashtë qindarka) lekë pa TVSH ose 1,449,977.65 (Një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e shtatë euro dhe gjashtëdhjetë e pesë cent) euro excluding VAT) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 28.08.2025 është 97.91 (nëntëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e një).

Për argumentimin e fondit limit grupi i punës i caktuar me urdher të titullarit të Ak-se, j'u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.
- Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt: “Çelësa TL/TM, Ndarësa TL/TM dhe TT për ambient të jashtëm”, ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me disa pajisje të cilat përdoren për mirëmbajtjen e Nënstacioneve dhe linjave 35 kV, në funksion të veprimtarisë së punës së AK.

Referuar procedurës së prokurimit, AK vlerëson se kjo procedurë prokurimi nuk mund të ndahet në Lote, pasi për arsye të tipologjisë së materialeve si nga pikepamja e funksionimit dhe instalimit të tyre, kanë një natyrë integruese në raport me njëra tjetren ashtu edhe me N/stacionet elektrike dhe linjat ku do instalohen. Krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë papërdorshmeri të perkohshme ose vonesa të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund të disponojë një element nga mallrat objekt prokurimi në vetë dhe të presë furnizimin e mallrave të tjera, në qoftë se këto janë të ndara në lote.

Gjithashtu, vonesat që mund të shkaktohen nga marrëdhëniet e me disa operatore ekonomike mund të vështirosojnë edhe nevojat e AK për ushtrimin e funksionit të saj, dhe mund të krijohen probleme me furnizimin e mallrave.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët*

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit AK do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari dorezojë dokumentat provues të parashikuara me sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kërkesave prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2022-2023-2024) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontrates me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacione të nevojshme se ku prodhohet malli dhe mundësinë reale për të bërë furnizimin, nëpërmjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalog** për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Për produktet e kompleteve të sensorit dhe rezistorit duhet të paraqiten kataloget e të gjithë elementeve perberes të tyre.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi katalogu i mallit tregon karakteristikat teknike të produkteve, me qëllim përmbushjeje të të gjitha kërkesave dhe specifikimeve teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Manualin e përdorimit për makineritë e shpimit në beton dhe në metal.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo ka të bëjë me mënyrën e maksimizimit të përdorimit dhe jetgjatësisë së produktit që furnizohet, duke garantuar Autoritetin kontraktor për mallin që furnizohet.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.3.5 Operatori ekonomik, për produktin Gaz SF₆, duhet të paraqese skeden e sigurise se të dhënave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo skede ka të bëjë me çilesin e produktit që furnizohet, dhe sigurinë e produktit duke garantuar Autoritetin kontraktor për mallin që furnizohet.

2.3.6 Operatori ekonomik, për produktin Gaz SF₆, duhet të paraqese flete analize.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi analize ka të bëjë me çilesin e produktit që furnizohet, duke garantuar Autoritetin kontraktor për mallin që furnizohet.

2.3.7 Operatori duhet të paraqese Raportet e testimit të prodhuesit ose distributorit dhe deklarate perputhshmerie për celesat 110 kV dhe 40.5 kV.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme dhe deklaratën e perputhshmerisë për të krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqese Skemen elektrike nga prodhuesi ose distributori për rezistencën e tokezimit të neutrit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo skema ndihmon autoritetin për menyrën e lidhjes së rezistencës.

2.3.9 Operatori duhet të paraqese Raportet e testimit të prodhuesit ose distributorit dhe deklarate perputhshmerie për Ndaresit 110 Kv.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme dhe deklaratën e perputhshmerisë për të krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.10 Operatori duhet të paraqese Raportet e testimit të prodhuesit ose distributorit dhe deklarate perputhshmerie për Transformoret 35 kV.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme dhe deklaratën e perputhshmerise për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.11 Operatori ekonomik, ne momentin e hapjes se ofertave pranë Drejtorisë së tensionit të Lartë OSSH Rruga Gramoz Pashko, duhet te paraqese nga nje moster te mallrave.

1. Makineri per shpim ne beton
2. Makineri per shpim elektromagnetik
3. Komplet sensori per temperaturen dhe lageshtine

Mos dorezimi i mostrave ne momentin e hapjes se ofertave ose mosperputhja e mallrave te ofruara me mostrat e paraqitura, eshte kusht per skualifikim.

Argumentim: Në zbatim të shkronjës a), pikës 6, të nenit 40, të Seksionit III, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Një kërkesë e tillë është e nevojshme për të konfirmuar nëse janë përmbushur kërkesat minimale të specifikimeve teknike të kërkuara për mallrat, objekt prokurimi.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqese Deklarate perputhshmerie te (CE Declaration of Conformity), ose ekuivalentet te njohura nderkombetarisht per sensoret dhe serverin e sensoreve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin deklarate perputhshmerie te Be për ti

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara dhe sipas standarteve të miratura europiane.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqese Deklarate perputhshmerie te (CE Declaration of Conformity) ose certifikata ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht ose standarde të tjera të pranuar ligjërisht në tregjet përkatëse), që vërtetojnë se makineritë e shpimit në beton dhe metal përmbushin kërkesat e sigurisë dhe të performancës. për makinerite e shpimit ne beton dhe ne metal.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin deklarate perputhshmerie te Be për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara dhe sipas standarteve të miratura europiane.

Shënim: *Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6, të nenit 26, parashikohet:*

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SHENIM: Per te gjithë standartet ose certifikatat e mesiperme pranohen edhe ekuivalentet e tyre Shqiptare. Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO ose cdo ekuivalent tjetër.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të brendshme DTL/ Grup pune pranë Autoritetit Kontraktor Përfitues DTL, për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, përllogaritje fondi dhe kriteret të vecanta kualifikuese në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36,

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

MINUTES - CONTRACT TYPE - GOODS

ON THE ARGUMENTATION AND APPROVAL OF TECHNICAL SPECIFICATIONS AND QUALIFICATION CRITERIA

Object of the procedure: “HV/MV Circuit breaker, Disconnectors, and Voltage Transformer for Outdoor Installation”.

Relevant code in the Common Procurement Vocabulary (CPV): Electrical equipment 31681000-3.

Value of the limit fund: 141,967,311.86 (One hundred forty-one million nine hundred sixty-seven thousand three hundred eleven lek and eighty-six cents) lek excluding VAT or **1,449,977.65** (One million four hundred forty-nine thousand nine hundred seventy-seven euros and sixty-five cents) euro excluding VAT. The exchange rate according to the Bank of Albania on 28.08.2025 is 97.91 (ninety-seven point nine one).

Argumentation regarding Article 39 of Law No. 162, dated 23.12.2020 “On Public Procurement”, as amended, for not dividing the procurement procedure into lots:

